

I. HYRJE.

Në fillim të viteve 90-të, ndodhën transformime të mëdha në ekonominë e vendit tonë si rezultat i kolapsit të sistemit ekonomik të centralizuar dhe, zëvendësimit të tij me ekonominë e tregut të lirë bazuar në pronësinë private. Gjatë viteve 1993-95 ekonomia shqiptare filloi të gjallërohej megjithëse, ritmet e zhvillimit të saj ishin ato të një ekonomie që karakterizohej nga një proces i madh ristrukturimi dhe reformash radikale. Situata makro ekonomike e vendit tonë, filloi të ndryshojë ndjeshëm pas vitit 2000. Treguesit kryesor ekonomik u përmirësuan ndjeshëm. Procesi i reformave, megjithë problemet e mëdha që e shoqëronin, karakterizohet nga trendi pozitiv me efekte të matëshme.

Në këtë proces, reformat dhe zhvillimet në sektorin e bujqësisë kanë patur efekte direkte në ritmet e zhvillimit ekonomik. Ekonomia shqiptare, në një pjesë të konsiderueshme të saj vazhdon të mbetet një ekonomi me karakteristikat e një vendi bujqësor.

Sektori më i rëndësishëm i bujqësisë është blegtoria. Ajo realizon rreth 60 % e të ardhurave vjetore të prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Gjedhi, të imtat, derri dhe shpendët janë sektorët më të rëndësishëm të blegtorisë.

Karakteristikë e ekonomisë bujqësore vazhdon të jetë dominimi i punës në familje. Rreth 90 % e fermave i plotësojnë nevojat për krahë pune me antarët e familjes. Vetëm rreth 1,9 % e fermave, i plotësojnë nevojat për krahë pune me puntorë me meditje.

Rritja e investimeve nëpër ferma blegtorale dhe modernizimi i tyre ka bërë, që përveç rritjes së prodhimtarisë, të rritet edhe cilësia e këtyre prodhimeve. Përmes investimeve të organizatave që përkrahin zhvillimin e bujqësisë, deri më tash janë ngritur disa ferma model të lopëve, të cilat po u krijojnë mundësi fermerëve vendorë, për aplikimin e praktikave më të mira të prodhimit sipas standardeve të Bashkimit Europian (BE).

Fermat moderne të rritjes së lopëve janë një sipërmarrje ekonomike dhe si të tilla, si objektiva kryesore të tyre janë maksimizimi i fitimeve dhe minimizimi i kostove të prodhimit. Planimetria e stallave të sotme dhe organizimi i proceseve të punës janë të orientuara drejt rritjes së rendimentit të prodhimit të qumështit, mishit, etj. por, përqëndrim i veprimtarisë vetëm drejt rendimenteve sa më të larta mund të sjellë pasoja negative për shëndetin e kafshës.

Ata janë të shumtë, nga zona të ndryshme të vendit, që e kanë trashëguar ndër breza krijimin e fermave e mbarëvajtjen e lopëve, që përpiqen të emancipohen e ta zhvillojnë me ritmet e kohës punën e tyre, për të prodhuar sa më shumë qumësht, me standarde të larta e me teknologji gjithmonë e më moderne, falë sigurisht bashkëpunimit që sigurojnë me kompanitë e mëdha të prodhimit të bulmetit.

Kushtet e mbajtjes në regjim stallor të lopëve sot nuk janë aspak të ngjashme me kushtet natyrore për të cilat ato kanë evoluar ndër vite. Çdo fermer duhet të ketë të qartë se shëndeti i lopëve është bazë e vlerësueshme drejt rendimenteve të larta të prodhimit dhe e suksesit në biznesin e tij.

Cënimi i shëndetit të lopëve të mbajtuara në regjim stallor, sjell pasoja të vlerësueshme për fermerin, ndër më evidentet mund të përmendim:

- ❖ Ulje e rendimentit të qumështit.
- ❖ Rënie e aktivitetit seksual pasi kafshët nuk ndjehen mirë (më pak shenja afshi, periudhë e zgjatur midis dy pjelljëve).
- ❖ Rënie në peshë.
- ❖ Shpenzime të larta qumështi nëpërmjet zgjatjes së periudhës së shërbimit.
- ❖ Kosto më të larta të fuqisë punëtore për menaxhimin dhe trajtimin e gjedhit me problem shëndetësore.
- ❖ Përqindje më të larta të skartimeve.
- ❖ Kostoja e blerjes së kafshëve të reja – përqindje të larta remonti
- ❖ Kostoja e trajtimit veteriner dhe medikamentet.

Subjekti është regjistruar pranë QKB me Subjekti Juridik “FERMA 1807” shpk është regjistruar pranë QKB me datë 08.04.2022, me numër NIPT-ti M21611004G.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: Tiranë, Vaqarr, VISHAJ, Vishaj, Zona Kadastrale 3784, Numër Pasurie 212/2.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: *“Mbarështrim i gjedhit, përpunim i qumështit, shitje me shumicë dhe pakicë, mish, qumësht dhe nënproduktet e tij. Tregti mallra industrialë, ushqimorë, Import – Eksport.*

Administrator është z.Fisnik Latifi nga 08.04.2022 deri 08.04.2027.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht:

- *Menaxhimi i mbetjeve, pika 5.3 c, Asgjesimi kmbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8).*
- *Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, pika 7.7 e, Trajtimi dhe përpunimi i qumështit (kapaciteti 5 t).*
- *Blegtoria, pika 7.8 d Rritje intensive e gjedhit në një instalim (kapaciteti 70 krerë).*

Kapaciteti i përpunimit/prodhimit:

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjediset e punës dhe në afërsi të tyre si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit është rezultat i disa faktorëve të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji Nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji Nr. 52/2020, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr.12/2015, datë 26.02.2015 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 23.01.2003 “Për vlersimin e ndikimit nëmjedis”.
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).
- Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlersimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis.”
- Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore.”
- Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009 “Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. Nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. Nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. Nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM Nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.

- V.K.M. Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M Nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit Nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin Nr. 8 datë 27.11.2007 “Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

3.1. Vendi ku zhvillohet veprimtaria.

Objekti në të cilin zhvillohet veprimtaria e rritjes së lopëve dhe e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij gjendet në fshatin Vishaj, të Njesisë Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë.

Teritori i Vaqarrit, përfshirë këtu edhe fshatin Vishaj, është fushor dhe kodrinor në të cilin, lartësia mesatare mbi nivelin e detit është rreth 150 m. Banorët e kësaj zonë merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori dhe një numër relativisht i vogël i tyre me prodhime artizanale si gdhendje në dru, qëndistari, etj.

Në fermat bujqësore familjare, banorët kultivojnë kultura të ndryshme bujqësore si foragjere, drithëra, perime të llojeve të ndryshme. Një pjesë e mirë e banorëve merren dhe me blegtori me mbarështimin e gjedhëve dhe me shitjen e qumështit dhe të nënprodukteve të tij.

Trulli i Subjektit “FERMA 1807” sh.p.k. përfshihet ndërmjet koordinatave të pasqyruara në tabelën në vijim.

X	Y
X1 = 4579146.87	Y1 = 5903894.87
X2 = 4579138.92	Y2 = 5903967.74
X3 = 4579200.79	Y3 = 5903978.09
X4 = 4579182.44	Y4 = 5903988.7
X5 = 4579115.42	Y5 = 5903969.89
X6 = 4579134.81	Y6 = 5903895.73

3.2. Infrastruktura inxhinjrike.

Infrastruktura inxhinjrike e kësaj ferme, përfshinë:

- a) Strukturat/objektet e strehimit të kafshëve,
- b) Strukturat/objektet e magazinimit, ushqimeve për kafshët dhe ato të magazinimit të produkteve.

- c) Strukturat/objektet e përpunimit të qumështit.
- d) Strukturat/objektet e magazinimit, qumështit dhe të magazinimit të nënprodukteve të tij.
- e) Rrjetin e furnizimit me energji elektrike.
- f) Rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm.
- g) Rrjetin e shkarkimit të ujërave të ndotur përfshirë këtu edhe vaskat e dekantimit.
- h) Rrjetin rrugor të brendshëm.

Në vartësi nga planifikimi/projektet, konstruksioni dhe funksionimi i këtyre objekteve inxhinjrike fermeri mund të sigurojë një efikasitet të lartë të fermës së tij.

a). Strukturat/objektet e strehimit të kafshëve.

Stalla.

Stalla e lopëve është e ndërtuar në mënyrë të përshtatshme për qëndrimin e kafshëve në të, funksionale dhe me hapësira të mjaftueshme për kryerjen e aktivitetit të kësaj ferme. Si aneks i kësaj stalle është edhe impianti i mjeljes së lopëve.

Kjo stallë është e ndërtuar me konstruksion metalik përfshirë këtu edhe mbulesën/çatinë e saj. Ajo përshkohet nga një koridor gjatësor, lindje-perëndim i cili shërben për lëvizjen e punonjësve që u shërbejnë lopëve të cilat qëndrojnë në grazhdet përkatës. Punonjësit e stallës, sjellin ushqimin e lopëve me mjete transporti dore dhe e shpërndajnë atë në grazhdet që gjenden në të dy anët e këtij koridori.

Grazhdi, është më i lartë se vendi ku rri lopa, me qëllim që lopa mund të hajë duke u ulur dhe nxjerrë kokën përpara. Ai është në një sipërfaqe të lëmuar dhe të ndriçuar mirë. Hapësira në grazhd siguron ushqim të njëtrajtshëm/uniform për kafshën, tretshmëri, ulje të rasteve me acidozë, mbingopje apo uri. Sipërfaqja e truallit të grazhdit është pa gropëzime dhe e qëndrueshme.


Zona e ndenjes dhe ajo e fjetjes.

Nëse lopës i ofrohet një hapësirë normale e nevojshme për qetësinë e sj, ajo mund të realizojë rreth 12 orë gjumë. Kjo kohë fjetjeje prej rreth 12 orësh, bën të mundur ripërthypjen intensive, nëpërmjet sekrecioneve të pështymës. Gjatë gjumit, qarkullimi i gjakut në gjijtë e lopës bëhet më intensiv dhe kështu përmirësohet sintetizimi i qumështit. Gjatë kohës së gjumit, arrihet lehtësimi i thundrave, i tendinave dhe i kyçeve.

Vendi i fjetjes së lopës duhet të jetë i butë, i thatë dhe i ajrosur mirë. “Shtretërit” duhet të jenë të ngritur jo më pak se 0.15 m dhe të mbuluar me kashtë të imët dhe të tharë mirë. Herë pas here, bëhet pastrimi dhe ndërrimi i kësaj kashte, me qëllim që të garantohet një pastërti e lartë.

Ajo ka një ashpërsi të mjaftueshme për të mos u bërë shkak për rrëshqitjen e kafshës gjatë lëvizjes nëpër të dhe njëkohësisht nuk pengon lëvizjen normale të ushqimit drejtë lopëve.

LINJA TEKNOLOGJIKE E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT FERMA 1807 SH.P.K



Harte :

- | | | |
|-------------------|------------------|--------------------------------------------|
| 1 - Vaske Djathi | 5 - Tanku Ftohes | 9 - Laboratori |
| 2 - Lavastovilje | 6 - Mbushes | 10 - Pompat nga Mjelja direkte e qumeshtit |
| 3 - Tanku Values | 7 - Frigoriferi | 11 - Dhoma Nderrimi/Punonjesish |
| 4 - Homogjenizues | 8 - Magazina | 12 - Banjo |

E rëndësishme është që:

- ❖ Sasia e ushqimit të mbetur në grazhd, **nuk duhet të kalojë 5 %**, të të gjithë sasisë ditore të ushqimit të ofruar kafshës.
- ❖ Në stallat me sistem të lirë, rritja e numurit të lopëve për një sipërfaqe të përcaktuar të stallës rrit dendësinë e tyre dhe për pasojë rritet konkurenca e tyre për ushqim, ujë, ajër, hapësirë dhe rehati.

Mikroklima e ambientit të stallës.

Konstruksioni ndërtimor i stallës bën të mundur që temperatura e ajrit brenda saj të jetë pothuajse e barabartë me temperaturën e ajrit jashtë saj. Gjatë stinës së nxehtë të viti, kur temperaturat e ajrit janë të larta bëhet qarkullimi i detyruar i ajrit brenda stallës 40 deri 60 herë në një orë. Ndërsa në stinën e ftohtë të vitit qarkullimi i ajrit të brendshëm bëhet 4 deri 6 herë në një orë.

Qarkullimi i ajrit të brendshëm rregullon parametrin e lagështisë relative, nivelin e temperaturës si dhe largon mikroorganizmat e dëmshëm. Lopët nuk janë të ndjeshme ndaj ajrit të ambientit, ato durojnë edhe rrymat e ajrit që lëvizin me shpejtësi 3-5 m/sek.

Drita/ndriçimi.

Studime të kësaj fushe kanë treguar që kohëzgjatja dhe intensiteti i dritës kanë ndikim të vlerësueshëm në rendimentin e qumështit të dhënë nga lopët. Treguesi më optimal është që sasia e orëve me dritë duhet të jetë 14-16 orë gjatë 24 orëve. Në mungesë të dritës natyrore, stallat sigurojnë një ndriçim artificial me një intensitet drite jo më pak se 200 lux. Ndiçimi i grazhdit dhe stallës në përgjithësi duhet të sigurojë pamje/vëzhgim të qartë të kafshëve edhe në orët e natës duke krijuar kushte të përshtatshme për shërbim ndaj tyre.

Uji.

Lopët konsumojnë 4-5 litra ujë, për çdo kilogram qumësht të dhënë prej tyre. Furnizimi me sasinë e nevojshme të ujit është një prej problemeve më të rëndësishme për të marrë një rendimet të lartë në sasinë e qumështit. Në rastin tonë lopët pijnë ujë nëpër korita prej druri, të cilat janë të vendosura në vende të përshtatshme për tu përdorur nga lopët si dhe për tu pastruar dhe furnizuar normalisht me ujë.

b). Strukturat/objektet e magazinimit, ushqimeve për kafshët.

Magazinat, struktura e tyre.

Ambjentet e magazineve në një fermë përfshijnë ato të magazinimit të mjeteve dhe veglave të punës, pajisjeve dhe ushqimeve blegtorale.

Gjatë ndërtimit dhe përdorimit/shfrytëzimit të magazinave duhet të mbahen parasysht:

- ❖ Mbrotjtja e tyre nga lagështia e tepërt, parazitët, këpurdhat, bakteret si dhe brejtësit.
- ❖ Hangarët duhet të jetë të pastër dhe të dezinfektuar me pluhur gëlqereje.

- ❖ Produktet blegtorale duhet të vendosen mbi një shtresë kashte të thatë, ose mbi paleta druri duke i mbrojtur ato nga kontakti i drejtpërdrejtë me lagështinë.
- ❖ Gropat e sillazhit, sillozët dhe/ose depozituesit e tjerë të sillazhit duhet të lyhen me të pastrohen mirë dhe të lahen me ujë të bollshëm, para përdorimit të tyre.
- ❖ Gropat e sillazhit, sillozët dhe/ose depozituesit e tjerë të sillazhit duhet të dezinfektohen pas përdorimit të tyre.
- ❖ Ushqimet e kafshëve duhet të jenë të ndara nga medikamentet.
- ❖ Pajisjet e përdorura në stalla dhe në kafshët që ndodhen në to, duhet të jetë të pastra dhe të dezinfektuara.
- ❖ Kujtesë! Mungesa e pastërtisë në këto stalla bëhet burim për shfaqjen e sëmundjeve serioze të kafshët.

c). Strukturat/objektet e përpunimit të qumështit.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e përpunimit të qumështit dhe e prodhimeve të qumështit e kosit për treg, prodhimin të djathrave, gizës, etj. është një objekt një katësh mbi tokë i rikonstruktuar dhe përshtatur mjaft mirë me veprimtarinë që zhvillohet aty. Muret janë të suvatuar e patinuar si dhe të lyer me bojëra sintetike. Një pjesë e lartësisë së mureve është e veshur me pllaka majolike të bardha. Po kështu edhe dyshemeja është e shtruar me pllaka majolike. Në muret anësore janë hapur dritare për marrjen e dritës natyrale, të cilat janë ndërtuar me duroalumin. Po kështu edhe dyert e jashme si dhe ato të komunikimit në ambjentet e brendshme janë bërë po me xham dhe duroalumin.

Pjesë e rëndësishme e kësaj godine janë edhe ambjentet [11], në të cilin janë vendosur garderoabat e punonjësve si dhe ambjentet hidro-sanitare [12], të përshtatshme dhe të plotësuara me të gjithë pajisjet e nevojshme.

Të gjithë këto elementë të ndërtimit të ambjenteve të brendshme të kësaj godine kanë krijuar një pamje të këndëshme dhe ç'është më e rëndësishmja kushte higjienike mjaft të mira.

Ky objekt është i lidhur organikisht me rrjetin inxhinjerik të zonës si dhe me rrjetin rrugor të saj.

3.3. Proçeset teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari.

3.3.1. Përkujdesi ndaj lopëve.

3.3.2. Prodhimi i qumështit dhe nënprodukteve të tij.

Më lart kemi pasqyruar në mënyrë skematike linjën teknologjike të përpunimit të qumështit me të gjithë pajisjet e instaluar për kryerjen e proçeseve teknologjike të përcaktuara.

Pajisjet teknologjike të përpunimit të qumështit.

Pjesë e rëndësishme e kësaj linje teknologjike, proçesi fillestar është objekti ku është vendosur pompa [10], e cila merr qumështin e dalë gjatë mjeljes së lopëve dhe, e dërgon në tankun values [3]. Në vijim qumështi l zjerë kalon në pajisjen homogjenizuesëe [4] dhe, më pas në tankun ftohës [5]. Pas këtij tanku ftohës, ssia e qumështit të përgatitur ndahet në disa rryma, si ajo e mbushjes së

shisheve të qumështit për treg[6], ajo e përgatitjes së kosit, e përgatitjes së djathit [vaskat e djathit [1] etj.

Qumështi i ardhur si lëndë e parë, qumështi në faza të ndryshme të procesit teknologjik si dhe, prodhime të kësaj linje teknologjike si psh qumështi për treg, kosi, gjalpi dhe djathrat e prodhuar etj. i nënshtrohen analizave fiziko-kimike në laboratorin [9].

Prodhimet e realizuara në këtë linjë teknologjike, pas inventarizimit të tyre, shkojnë respektivisht në dhomën frigoriferike [7] dhe, në magazinën e produktit të gatshëm [8].

Në këtë baxho qumështi, gjenden dhe përdoren një shumëllojshmëri formash/enësh për përpunimin e djathit.

Të gjitha këto makineri e pajisje punojnë në mënyrë të automatizuar gjatë zhvillimit të procesit teknologjik të përpunimit të qumështit për marrjen e nënprodukteve të tij. Punëtori që shfrytëzon këtë linjë teknologjike, vendos komandat e duhura në panelet e komandimit të çdo pajisjeve dhe pas kësaj ai bën rolin e vëzhguesit të zhvillimit të procesit. Në procese të caktuara është e nevojshme edhe puna e drejtpërdrejtë e punëtorëve, sidomos në proceset e transportit të djathit si dhe në ato të pastrimit të makinerive dhe pajisjeve etj.

Qumështi i nënshtrohet përpunimit termik para konsumit si dhe para proceseve teknologjike të përpunimit të tij për prodhimin e produkteve të tilla si gjalpë, kos, lloje të ndryshme djathrash, etj. Qëllimi i trajtimit të qumështit me nxehtësi lidhet me ndikimin që ka temperatura e lartë mbi ngarkesën mikrobike të pranishme në qumështin e freskët, ngarkesë kjo që pas përdorimit të nxehtësisë mund të pakësohet apo të eliminohet. Përpunimi termik konsiston në përdorimin e këtyre metodave:

- i. pasterizimi ose temperaturë e lartë në kohë të shkurtër;
- ii. sterilizimi ose temperaturë shumë e lartë në kohë të shkurtër;

Trajtimi i qumështit me TLKSH, përfshin fazat e mëposhtme:

- paranxehjen;
- pastrimin;
- heqjen e yndyrës;
- homogjenizimin;
- pasterizimin.

Pasterizimi :

Pasterizimi është procesi që bën të mundur eliminimin e të gjitha mikroorganizmave nëpërmjet nxehjes së qumështit për një fraksion shumë të shkurtër kohor e më pas ftohjes së tij të menjëherëshme. Qumështi i pasterizuar duhet ruajtur në temperatura të ulta nga konsumatori. Trajtimi termik në përgjithësi kryhet në temperaturën 75-83 °C për rreth 15 sekonda.

Homogjenizimi :

Homogjenizimi i qumështit bëhet duke e kaluar atë në sipërfaqe të ngushta me presion të lartë. Madhësia e piklave të yndyrës zvogëlohet deri 5 herë. Përbërësit e kazeinës shkatërrohen dhe ngjiten në sipërfaqen e piklave të yndyrës. Këto dy dukuri rritin qëndrueshmërinë e emulsionit. Homogjenizimi bëhet zakonisht në 70⁰C, shpesh pas pasterizimit.

Qumeshti I homogjenizuar ka disa përparësi krahasuar me atë të pa homogjenizuar. Këto janë :

- i. Është më rezistent ndaj ndryshimeve të temperaturave apo presioneve.
- ii. Ka një jetëgjatësi më të madhe.
- iii. Është më i tretshëm sesa qumështi i pa homogjenizuar.
- iv. Ka shije më të mirë dhe, është me kremoz.

Prodhimet e realizuara.

Djathi.

Djathi është një formë e konservimit të dy përbërësve të patretshëm të qumështit, kazeines dhe yndyrës. Djathi konsiderohet si produkt i maturimit të fituar nga koagulimi me presim apo acid i qumështit të plotë ose të skremuar, me apo pa shtesa të kripës dhe ngjyruësve.

Djathi është një produkt që përbëhet nga proteina dhe yndyrë e njëjtë me atë të qumështit, zakonisht prej qumeshtit të lopës dhe deles. Normalisht qumështi acidifikohet paraprakisht e më pas shtohet një enzimë që, realizon koagulimin e kazeinës. Forma solide e krijuar, ndahet dhe i nënshtrohet përpunimit drejt një forme përfundimtare.

Gjalpi.

Gjalpi është produkt i fituar nga krema e qumështit të lopës që i përmbush të gjitha karakteristikat organo-leptike, analitike dhe higjieno-sanitare të stabilizuara në standartin.

Është një produkt stabël nga pikëpamja mikrobiologjike që ka një përmbajtje të ulët të ujit, rreth 1,5%, dhe një përmbajtje të lartë të yndyrës, rreth 80%. Gjalpi i prodhuar nga kremi i ëmbël është i varfër me baktere, ndërsa produktet e prodhuara nga kremi acid përmbajnë sasi të mëdha të streptokokëve laktikë.

Këto janë dy produktet bazë të kësaj vepritarije. Në përfundim të procesit të prodhimit ato i nënshtrohen procesit të ambalazhimit dhe etiketimit në plotësim të kërkesave të legjislacionit përkatës të vendit tonë.

IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

4.1. Lëndët e para.

Si lëndë të para në kujdesin ushqimor për lopët, mund të përmendim jonxhën, misrin dhe elbin.

Jonxha.

Jonxha është bimëbishtajore dhe, një nga bimët foragjere më të rëndësishme. Ajo luan një rol të rëndësishëm në ushqimin e kafshëve sidomos të gjedheve për prodhimtari të qumështit.

Vlera ekonomike dhe ushqyese e jonxhës është e shumëanshme në të ushqyerit e kafshëve, në gjendje të gjelbër dhe në formë të barit të thatë (sanës) dhe, përbën një ushqim shumë të vlefshëm e me vlera të larta proteinike dhe energjetike për të gjitha llojet e kafshëve.

Prodhueshmëria e lartë e jonxhës, aftësia e saj për tu ripërtërirë shpejt, prania e madhe e gjethe të pasura me proteina dhe vitamina e bëjnë këtë bimë një foragjere të klasit të parë. Ajo mund të japë 4-5 kositje bile edhe më shumë brenda një viti.

E vetmja e metë që paraqet jonxha është se shkakton timpani (fryerje e stomakut) në gjedhët kur këto kullosin në jonxhishte në faza të hershme të bimbës dhe kur ka shumë lagështi.

Sana e jonxhës mund të përgatitet nga bimët e kositura para lulëzimit, në lulëzim dhe pas lulëzimit. Cilësi më të mirë të sanës së jonxhës fitojmë kur jonxha kositet në fazën formimit të sythave. Gjate tharjes së sanës së jonxhës, duhet pasur kujdes që mos të humbët vlera ushqyese. Sana e jonxhës karakterizohet me sasi më të larta të proteinave, kalciumit dhe karotinës duke e krahasuar me sanën e livadheve. Përmbajtja e proteinave sillet prej 10.8-20%, e celulozës prej 19.8-35%, yndyrës prej 1.27-2.3%, e kaliumit prej 1.2-1.52%, e fosforit prej 0.20-0.22%.

Përmbajtja e njësive ushqyese në sanën e jonxhës sillet prej 0.41-0.53 NjU. Të gjitha kafshët e konsumojnë me ëndje sanën e jonxhës, sidomos lopët qumështore. Gjedheve u jepet prej 3-14kg në ditë varësisht nga faza në të cilën gjendet.

Misri.

Misri, është një drith i zbutur nga njerëzit që në kohët parahistorike. Misri përdoret në jetën e përditshme për përgatitjen e bukës, prodhimin e vajit etj. Misri, është një bimë njëvjeçare me kërcell të fortë e të gjatë si kallam, me gjethe të mëdha heshtore, që nxjerr në majë lule si tufë, bën kallinj të mëdhenj, me koçan të fortë, të mbështjellë me fletë të gjelbra e me kokrra të bardha a të verdha. Kokrrat e këtij drithi, hahen të ziera a të pjekura, ato bluhen miell për bukë dhe/ose për gatesa të ndryshme. Misri përdoret edhe si ushqim për bagëtinë.

Ushqim i koncentruar.

Në ditët e sotme vërehet një tendencë e ushqimit të lopëve edhe me koncentrat, duke zvogëluar sasinë e ushqimit voluminoz. (sanë, kashtë, silazh) dhe më shumë në koncentrate.

Duhet treguar kujdes i veçantë në balancimin e lëndëve ushqyese sidomos të energjisë, mineraleve, kaliumit dhe fosforit sili dhe kripës.

Po ashtu, duhet t'i kushtohet shumë vëmendje edhe sasisë së lëndës së thatë, e cila jepet maksimalisht 1.5-3.0 kg/100 të masës trupore, ushqimet voluminoze: 0.5-0.8 kg/100 kg të masës trupore, ndërsa koncentratit jepet sipas nevojë. (misër 84-85 %; hime gruri 10 %; sojë 4 % premix 1%; kripë 0.5%).

Silazhet.

Silazhet pranverore, si faktorë kryesorë në ushqimet voluminoze për prodhimin e qumështit, duhet të kenë 30% deri në 40% lëndë të thatë. Masa e njomë, që do të silazhohet,

duhet të qëndrojnë në fushë maksimumi për një ditë, në mënyrë që humbjet e karbohidrateve të foragjerëve të minimizohen. Kështu arrihet një ngjeshje optimal e masës së njomë. Për një silazh me përçindje të ulët të lëndës së thatë (eventualisht përzierja me kashtë të thatë) është më optimal se sa lënia në fushë e silazhit për një kohë të gjatë dhe si pasojë në humbje të mëdha.

Qumështi.

Qumështi është një likuid i bardhë, opak që prodhohet nga gjendrat mamare tek gjitarët femërorë. Ai përbën burimin kryesor të ushqyerjes për gjitarët e porsalindur, përpara se ato të bëhen të aftë për të tretur dhe përthithur ushqime të tjera.

Komponentet e saktë të qumështit të gjitareve ndryshojnë në varësi të specieve por, ajo që është e sigurtë, është fakti se përmbajnë një sasi të konsiderueshme të lipideve të saturuar, proteina, kalcium, si dhe vitamine C.

Përbërësit kryesor të qumështit:

Yndyra e qumështit, Yndyra e qumështit është e përberë kryesisht nga trigliceride (97-99%) dhe në sasi më të vogla nga fosfolipide, sterole (kolesteroli) dhe vitamina A, D, E, K. si dhe disa pigmente ngjyrues që i japin edhe ngjyrën karakteristike.

Laktoza (sheqeri) i qumështit. Laktoza është një kombinim i glukozës me galaktozen dhe ka një shije të ëmbël të lehtë. Laktoza sintetizohet në gjëndrën e qumështit, por burim e ka glukozën që vjen nga gjaku. Laktoza është një sheqer që fermentohet lehtë. Procesi i fermentimit të tij dhe transformimi i tij në acid laktik dhe lëndë tjera sekondare luan rolin me rendësi në formimin e aromës së qumështit si: djathit, etj.

Laktoza është një sheqer rezistent karshi nxehtësisë. Në temperaturën 170-180°C, ajo karamelizohet. Laktoza ka një rol me rendësi në mbrojtjen e qumështit karshi shtameve mikrobike që kanë një veprim shkatërrues mbi proteinat.

Proteinat në qumësht. Prezenca e një sasive mesatare proteinash në qumështin e lopës, mund të ndryshojë nën veprimin e disa faktorëve: Racës, Faktorëve gjenetik, Laktacionit. Proteinat e qumështit janë: a) Kazeina, b) Laktoalbumina, c) Laktoglobulina

Kriprat minerale në qumësht. Qumështi përmban materie të ndryshme minerale. Disa prej tyre siç janë kalciumi dhe fosfori, janë të lidhura me materie organike. Përveç tyre në qumësht ka dhe një numër mineralesh, qoftë dhe si gjurmë: Na, Ca, Fe, Al, Mn, Zn, Cu, etj. Përberësit mineral në qumësht ndahen në bazik (Na, Ca, Fe) dhe acide (acidi fosforik, klorhidrik, sulfurik dhe karbonik).

Vitaminat në qumësht. Në qumësht janë të përfaqësuara shume vitamina. Vitaminat në qumësht nuk sintetizohen në gji, por ato rrjedhin nga gjaku. Sasia e tyre në qumësht, ndikohet shume nga tipi i të ushqyerit, raca dhe gjendja fiziologjike. Vitaminat e tretshme në yndyra Grupi I-re hyjnë: A, D, E, K. Në grupin e II-të të Vitaminave të tretshme në ujë hyjnë: Vitaminat B1, B2, B6, B12. Vitamina C.

Qumështi i lopës, ka një pH që varion nga 6.4-6.8 duke e bërë atë lehtësisht acid.

4.2. Energjitë që përdoren.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e rritjes së lopëve dhe e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, është i lidhur me rrjetin inxhinjrik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjrik janë, ai i:

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm.
- ✓ Shkarkimit të ujrave të ndotur.
- a. Furnizimi me energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone.

Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për vënien në punë të pajisjeve të instaluar në bazhon e qumështit, përfshi këtu edhe dhomën frigoriferike si dhe ndriçimin e ambjenteve të punës, rrugëve etj.

Fuqia elektrike e instaluar në këtë karrierë është rreth 75 kËh.

- b. Furnizimi me ujë.

Uji përdoret për disa qëllime të caktuara në veprimtarinë e këtij subjekti. Ai është i nevojshëm në plotësimin e nevojave për ujë të pijshëm të lopëve që rrinë në regjim stallor si dhe në pastrimin e mjeteve/veglave të punës dhe të ambjenteve të stallës.

Uji përdoret njëkohësisht në disa procese teknologjike tek baxho e qumështit si dhe për larjen e pajisjeve dhe ambjenteve të punës në këtë baxho qumështi.

Uji, përdoret njëkohësisht për plotësimin e nevojave humane, të gjithë punonjësve që punojnë në kujdesin ndaj lopëve dhe në baxhon e qumështit.

Konsumi mesatar mujor i ujit shkon në rreth 12 m³.

- c. Përdorimi i lëndës djegëse, naftë.

Për të plotësuar nevojat e transportit të brendshëm të subjektit si psh lëvizjen e punonjësve (marrjen dhe largimin nga puna), transportin e ushqimit për lopët, transportin e qumështit dhe të nënprodukteve të tij, në subjektet tregtare etj. subjekti ka në përdorim disa automjete transporti të cilat punojnë me lëndë djegëse naftë. Nafta, blihet në subjekte të licensuar për magazinimin dhe tretimin e saj.

Konsumi naftës shkon mesatarisht në rreth 350 litra/muaj.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

5.1. Rritja e lopëve në regjim stallor.

5.1.1. Shkarkime në ajër.

Zhvillimi i aktivitetit të rritjes/kujdesit stallor për lopët nuk gjeneron shkarkime në ajër. Nga ky aktivitet kemi praninë e aromave të pakëndësme të vijinë nga jashtëqitjet e kafshëve. Përhapja

e këtyre aromave është e kufizuar në ambjentet jashtë stallës dhe, është me pak ndikim në banorët e zonës.

5.1.2. Shkarkimi i ujrave të ndotur.

Rritja e lopëve në regjim stallor, shoqërohet me shkarkime të ujrave të ndotur, në përbërje të të cilave është urina e lopëve si ujrat e ndotur me pluhura, mbetje ushqimore të lopëve dhe jashtë qitje të tyre, gjatë pastrimit të ambjenteve të stallës. Këto ujra të ndotur mblidhen në një kolektor, duke rrëshqitur përgjatë dyshemesë së stallës, për shkak të një pjerrësie të saj. Ky kolektor i dërgon ujrat e ndotur në dy vaska dekantimi.

Ujrat e zeza shkarkojnë në një gropë septike.

5.1.3. Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i kësaj veprimtarije shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat përbëhen kryesisht nga jashtëqitjet e kafshëve dhe, mbetjet ushqimore të tyre.

Këto mbetje të ngurta që mund të quhen edhe teknologjike, pastrohen në mënyrë periodike nga stalla e lopëve dhe shkojnë në një gropëdekantimi dhe përpunimi të tyre.

5.1.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjatë punës për përkujdesjen/rritjen e lopëve për qumësht, nuk gjenerohen zhurma, të tjera nga ato të pëllitjes së lopëve.

Krahas tyre, kemi edhe zhurmat e gjeneruara nga lëvizja e mjeteve të transportit.

Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 75 dBA.

5.2. Prodhimii qumështit dhe nënprodukteve të tijë.

5.2.1. Shkarkime në ajër.

Gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij si qumësht për treg, djathi, gjalpi etj, nuk kemi shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurave në ambjentet e punës dhe jashtë tyre.

5.2.2. Shkarkime të ujërave të ndotur.

Gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij, nuk gjenerohen ujra të ndotur teknologjike. Ujrat e shkarkuar, ndoten gjatë pastrimit të paajisjeve të instaluar si dhe të pastrimit të ambjenteve të punës.

5.2.3. Shkarkime në tokë.

Gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij, nuk kemi shkarkime të mbetjeve teknologjike të ngruta.

Gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije kemi gjenerim të mbetjeve të ngurta urbane.

5.2.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjatë zhvillimit të proçeseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij kemi gjenerim të zhurmave në ambjentet e punës, gjatë punës së pompave, transportjerëve, pajisjeve të mbushjes së shisheve etj. Janë zhurma me intensitet relativisht të ulët, të cilat nuk pengojnë zhvillimin e bisedave të punonjësve. Këto zhurma nuk ndjehen në ambjentet e jashtë të godinës.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Veprimtaria që vlerësohet në këtë raport, gjendet në Fshatin Vishaj, që ndodhet në administrimin e njësisë së qeverisjes vendore Vaqarr të Bashkisë Tiranë.

Rrethi i Tiranës shtrihet në koordinatat gjeografike 41° - 19° gjerësi veriore dhe 19° - 49° gjatësi lindore. Nga veriu kufizohet me Krujën dhe Matin; nga verilindjame Bulqizën; nga juglindja me Librazhdin; nga jugu me Elbasanin dhe me Peqinin; nga jugperëndimi me Kavajën dhe nga perëndimi me Durrësin.

Njësia Administrative Vaqarr shtrihet në një territor kryesisht fushor-kodrinorku lartësia mesatare është rreth 150 m mbi nivelin e detit, duke përfshirë sipërfaqje të konsiderueshme të tokave arë, pyjeve, livadheve dhe kullotave.

Vaqarri shtrihet në jug perëndim të Tiranës rreth 6 km larg saj.

Pejsazhi dhe ndërtimi topografik i rajonit ku zhvillohet kjo veprimtari është ai i një zone të banuar rurale, në të cilën mbizotërojnë banesat publike një deri dy katëshe të rrethuara me oborre të gjelbëruara dhe toka të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore.

Objekti ku zhvillohet veprimtari e kujdesit/rritjes së lopëve dhe e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

X	Y
X1 =	Y1 =
X2 =	Y2 =
X3 =	Y3 =
X4 =	Y4 =

6.1. Përshkrim të faktorëve klimatikë.

Rajoni i Tiranës përfshihet në zonën e Ultësirës Bregdetare në nënzonën mesdhetare kodrinore juglindore e cila, influencohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të shkurtër e të butë dhe me verë të nxehtë e të thatë.

Territori i Tiranës, ka një relief të thyer dhe kështu, edhe klima e tij është e larmishme, me verë të ngrohtë e të thatë në zonën kodrinore e fushore dhe, me dimër të ftohtë, deri edhe me erëra

ereshje bore,në zonën malore.Elemente tërëndësishme të klimës nën ndikimin e mutacioneve përkatëse reflektohen nëecurinë e reshjeve dhe të temperaturës së ajrit.

Tirana ka 331 ditë mediell në vit,të shpërndara sipas muajve të vitit.Intensiteti i rrezatimit të drejtperdrejtë të diellit është më i lartë në muajin maj,ndërsa më i ulëti në dhjetor.Kjo tregon se në muajt maj e dhjetor.

Faktorët kryesorë që kushtëzojnë zgjatjen e diellzimit janë gjerësiagjeografike,pozicioni i vendit të majtjes,vranësirat etj.

Erërat, e zonës së Ultësirës Bregdetare,ku përfshihet edhe Tirana,e ndryshojnëshpesh drejtimin dhe shpejtësinë.Ky fenomen ndikohet nga ciklonet që kalojnë nëdetin Mesdhe dhe mbi Gadishullin Ballkanik si dhe, nga faktorët locale, të tillë si afërsiame detin, vendosja dhe drejtimi i vargmaleve, i luginave, i lumenjve etj.NëUltësirën Bregdetare ndihen edhe erërat e nxehta e të thata,por më shpeshhasen erërat që fryjnë nga jugperëndimi dhe nga jugu.Shpërndarja më e madhevjetore e drejtimit të erërave është qëndror, juglindor dhe veriperëndimor.Shpejtësia mesatare e erërave sipas drejtimit të fryrjes së tyre është:

- Në drejtimin juglindor 2.5 m/s;
- Në drejtimin veriperëndimor 3m/s.
- Shpejtësia mesatare vjetore: 1.6m/s.

Reshjet, në rrethin e Tiranës më së shumti bien në formën e shiut.Malësia e Tiranës ka 125-135 ditë me reshje në vit.Lagështia mesatare ditore eajrit është 70%.Lagështia maksimale në ditë 42-48%. Tirana ka një thatësi të zgjatur prej 8 deri në 10 javë në vit por, që shkonedhe në10-12 javë në vit.Malësia e Tiranës shquhet për reshje breshëri, duke shënuar një tregues prej, mesatarisht 8.1 ditë nëvit.Muajt më të ngarkuar me reshje janë :janari,shkurti,marsi dhe prilli.

Reshjet e borës janë një dukuri e rrallë në Tiranë dhe, në zonëfushore e kodrinore të këtij rrethi.

6.2. Peisazhi dhe Topografia.

Relievi, rrethi i Tiranës ka një reliev të thyer e të larmishëm,që nis me male të larta në lindje,vijon me kodra përafërsisht të ulëta në jug e në perëndim dhe, mbaron mefushë nga veriperëndimi.

Fushat.Fusha e Tiranës përfshihet në zonën e Ultësirës Bregdetare.Fusha e Tiranës është rreth 15km e gjatë dhe 9km e gjerëndërsa, lartësia e saj, mbi nivelin e detit është 521m. Në jug kjo fushë kufizohet mekodrat e Vaqar-Sharr-Sauk-Farkë; në lindje me kodrat Ibë-Linzë-Mukje dhe nëperëndim me vargun kodrinor Vorë-Erzen. Kjo fushë përfshin brenda saj të gjithëhapësirën që shtrihet në të dy brigjet e lumit të Tiranës,deri në rrjedhjen elumit të Tërkuzës.Ajo rrethohet nga të tria anët me kodra dhe vetëm në veri është e hapur dhe shtrihet deri në Fushë-Krujë e Fushë-Ishëm, derisa takon detin në Kepin e Rodonit. Më tej kjo fushë, takohet me fushën e Bregut të Matës pranëLezhës e Shëngjinit,ku vijon Ultësira e Shkodrës.

Malet.

Rrethi i Tiranës ka dy male:

- Malin e Dajtit 1612 m i lartë,gjithnjë i gjelbëruar,që bashkë me Malin e Krujës(1229) i bëjnë zonës një mur mbrojtës nga ana lindore.Pas Dajtit vjen krahina malore e Shëngjergjit dhe eBenës,të pasura me kullota.Këto jane pjesë e Malësisë së Tiranës e të Krujës.

- Mali me gropa ,1828 m i lartë, gjendet po nga ana lindore dhe duket si i fshehur pas shpinës së Dajtit. Pas tij,në lindje,shtrihen krahinat malore e Martaneshit dhe Çermenikës.

Kodrat.

Kodrat e rrethittë Tiranës janë përgjithësisht të ulëta.Ato I përkasin periudhës së shtresimeve aluvionale.Lartësia e tyre mbi nivelin e detit nis nga 30-40 m në pjesën veriperëndimore dhe shkon deri në 120 m në pjesën juglindore.Nga jugu,Fusha e Tiranës mbaron me kodrat e ulëta të Saukut dhe të Selitës.Disa kilometra më tutje, gjithnjë në drejtim të jugut,vargu kodrinor ndërpritet nga lumi i Erzënit.Këtu nis masivi kodrinor-malor i Petrëlës dhe i Kërrabës,që vazhdon e shtrihet deri ne luginën e Shkumbinit.Nga anaperëndimore e Fushës janë vargu i kodrave të Bardhëzës,Kasharit dhe Prezës,qëe ndajnë atë nga deti.Kodrat e anës jugore e perëndimore të Fushës së Tiranës,bëjnë pjesë në vargun e parë kodrinor të krahinës:Rodon-Prezë-Vorë-Yzberisht(Erzen).

Pejsazhi i zonës në të cilën zhvillohet projekti i propozuar është ai i një zone rurale.

6.3.Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Mbi sipërfaqen e truallit të rrethit të Tiranës rrjedhin disa lumenj e përrenj, shumica e të cilëve zbresin nga malii Dajtit.Dy më të rëndësishmit prej tyre janë, Lumi i Tiranës dhe Përroi i Lanës.

Lumi i Tiranës,është 10.3 km i gjatë.Ai,rrjedh nga shkalla e Tujanit dhe kalon përmes fushës,në veri të qytetit.Përtej Rinasit takohet me Tërkuzën,që vjen nga Malësia e Krujës.Lumi vijon rrugën nëpër Fushë-Krujë,në fshatin Bilaj,ku takohet me lumen tjetër të vogël, si Zeza, i cili rrjedh po nga Malësia e Krujës.Në këtë pikë, ujërat e tyre bëhen njësh në shtratin e lumit Ishëm dhe shkojnë e derdhen në gjirin e Rodonit.

Lumi i Tiranës dhe i Tërkuzës, kanë formuar dy tarraca në Fushën e Tiranës.Mbi njërin prej tyre,që ka një pjerrësi të lehtë nga lindja në perëndim,është vendosur një pjesë e madhe e kryeqytetit.

Përroi i Lanësështë 15.3 km i gjatë.Ai buron në fshatin Shkozë dhe përshkon tej përtej kryeqytetit.Pjesa e përroit që kalon në qytet,është e futurë në një shtrat betoni,me shpate të gjelbëruara,të mbjella me lule e pemë dekorative.

Liqenet.Tirana ka katër liqene artificiale,të krijuara nga dora e njeriut.

Liqeni i Tiranës,ndodhet në Parkun e Madh,në lartësinë 118m mbi nivelin e detit dhe, ka një sipërfaqe prej 55ha dhe, një thellësi deri në 5.5m.

Liqeni i Kodër-Kamzës,ndodhet në lartësinë 173m mbi nivelin e detit dhe, ka një sipërfaqe prej 25ha dhe, një thellësi deri në 3.2 m.

Liqeni i Farkës,ndodhet në lartësinë 260m mbi nivelin e detit dhe, ka një sipërfaqe prej 55ha.

Liqeni i Tufinës, ndodhet në lartësinë 240m mbi nivelin e detit dhe, ka një sipërfaqe prej 4 ha.

Pasuri të tjera ujore.

Burimet më të mëdha ujore, zona e Tiranës i ka në zonën lindore malore të saj.Nga Mali me Gropa dhe ngamalësia Krujë-Dajt,burojnë gati të gjithë lumenjtë e përrenj,të përshkruajnë elagin fushën e Tiranës.Ata shkojnë më tej,derisa derdhen në kepin e Rodonit.

Ishmi,edhe pse nuk është lumë i Tiranës,mund të studiohet në burimet ujore të këtij rrethi.Shtrati i tij mbushet nga ujërat e lumit të Tiranës dhenga dy degët e tjera,Tërkuza dhe Zeza.Lumi Ishëm ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 673 m²,prurja mesatare e tij është 30 m³/s.

Erzeni, është një tjetër lumëqë, ndonëse nuk i përket Tiranës, është lidhur me këtë trevë. Ai buron në afërsi të qafës së Rinasit, në lartësinë 1350 m mbi nivelin e detit dhe, ka një sipërfaqe ujore prej 760 km² njëdhe prurje 18 m³/s dhe një gjatësi prej 109 km.

Burimet ujore.

Burimi i Selitës del në rrëzën jugperëndimore të Malit me Gropa, nga një masiv gëlqeror karstik në lartësinë 981 m mbi nivelin e detit. Ai ushqehet kryesisht nga reshjet e shiut dhe nga shkrirja e borës. Prurja mestare ujore e Selitës është 520 l/s por, me raste arrin mbi 1000 l/s. Prurjet më të mëdha janë në dhjetor dhe në maj. Uji i burimit të Selitës është i pastër, i ftohtë dhe i shëndetshëm.

Burime të tjera janë: Shën Maria me 270-380 l/s ; Pëllumbasi me 250- 800 l/sek; Bovilla me 110-850 l/sek.

Ujërat nëntokësore.

Fusha e Tiranës është pjesa më jugore e pellgut ujëmbajtës Tiranë-Ishëm, që përbëhet kryesisht nga prurjet aluvionale të Lumit të Tiranës, Lanës dhe Tërkuzës. Ndërtimi shkëmbor e ranor i nëntokës së Tiranës dikton ujëmbajtje të ulët dhe në thellësi deri në 10-15 metra. I tillë është formacioni i vargut Mëzes, Skuterë, Prezë, Pezë si dhe nga ana perëndimore i vargut të Priskës. Vargu i krahut lindor të Priksës dhe ai i Ibës, Ndroqit e Kuq, janë më të pasur me ujëra nëntokësore, që arrijnë deri në 0,57 litra/sek.

6.4. Flora dhe fauna e kësaj zone përbëhet nga ajo e butë që trajtohet nga banorët si dhe ajo e egër.

Pyjet zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në zonën e Vaqarrit. Në krahun e djathtë të rrugës Tiranë – Durrës ndodhet një nga sipërfaqet me pyllëzim më të dendur dhe më të veçantë të llojit pishë Kjo sipërfaqe e pyllëzuar shtrihet kryesisht në fshatrat: Lalm, Allgjatë, Prushaj dhe Gropë.

Banorët vendorë trashëgojnë nga të parët e tyre praktika dhe njohuri të përcjella brez pas brezi mbi përdorimin e tokës bujqësore dhe asaj pyjore, ku organizojnë dhe mbështesin jetën e familjeve të tyre.

Kulturat bujqësore.

Në rrethin e Tiranës kultivohen bimë të arave si, gruri, misri, thekra, elbi, duhani, luledielli, etj. krahas tyre kultivohen edhe perime si domatja, speci, patëllxhani, bamja, lakra, spinaqi, lëpjeta, qepa, hudhra, kastravec, majdanozi, kopra, kungulli, sallata jeshile, karota etj. Pemëtaria zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e këtij rrethi. Janë kultivuar me kohëulliri, rrushi, fiku, dardha, agrumet, kumbulla, pjeshka, bostani, shalqirietj.,

Blegtoria.

Përveç bujqësisë, blegtoria është degë tjetër e rëndësishme e ekonomisë së këtij rrethi. Zhvillimi i saj mundësohet nga, kushtet natyrore, nga sipërfaqja pyjore dhe e kullotave, si dhe nga një traditë e trashëguar brez pas brezi në këtë sektor jetik. Në fshatra mbarështohen kryesisht gjedhët (lopët dhe qetë), bagëtiti e imëta (dhen e dhi), derrat, shpendët etj. Në familjet fermere, sipas kushteve, mbahen edhe kafshë pune si, kuaj, mushka, gomarë, që shërbejnë për transport produkteve, ose përpunimin e tokës.

Në këtë zonë ndeshemi kryesisht me shpend vendas apo emigratorë, zvarranikë, etj. Zogjtë që jetojnë këtu janë trumcakë, mëllenja, etj. Ndër zvarranikët mund të përmendim breshkë toke mesdhetare (testudo hermani), gjarpërinj, hardhuca (Lacerta viridis), bretkosa të vogla të zakonëshme uji (rona lessonae), etj.

Speciet e faunës dhe të florës të takuara në këtë zonë, u kërkuan për t'u gjetur në speciet në rrezik të faunës dhe të florës të detajuara dhe të vlerësuara në "Libri i Kuq i Faunës Shqiptare" dhe "Libri i Kuq i Florës Shqiptare", dy libra këto të publikuar nga Ministria Mjedisit, respektivisht në vitin 2006 dhe 2007. Nga ky verifikim rezulton se, nuk kemi asnjë prej llojeve /specieve të pranishme në këtë zonë me llojet/speciet e listuar në këto libra.

6.5. Cilësia e ajrit në zonë.

Zona e fshatit Vishaj, ku zhvillohet kjo veprimtari e administruar nga Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, nuk është e përfshirë në monitorimin e cilësisë së treguesve mjedisor, të kryer nga AKM Tiranë.

Nga të dhënat zyrtare të publikuara, mbi treguesit cilësor të gjendjes mjedisit, të këtij rajoni mund të pohojmë se kjo zonë rurale nuk është ndikuar nga shkarkimet në ajër, nga veprimtaritë e linjave të prodhimit të ndryshme industriale

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së rritjes/kujdesit ndaj lopëve për qumësht si dhe e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tijë, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshi këtu edhe të mbetjeve urbane.

7.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Zhvillimi i aktivitetit të rritjes/kujdesit stallor për lopët nuk gjeneron shkarkime në ajër. Nga ky aktivitet kemi praninë e aromave të pakëndëshme që vijnë nga jashtëqitjet e kafshëve. Përhapja e këtyre aromave është e kufizuar në ambientet jashtë stallës dhe, është me pak ndikim në banorët e zonës.

Nga zhvillimi i veprimtarisë për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e nënprodukteve të tij, nuk kemi shkarkime në ajër.

Në territorin e këtij subjekti kemi shkarkim në ajër të gazeve që vijnë si rezultat i qarkullimit të mjeteve të ndryshme të transportit.

Shënim: Aktiviteti që zhvillon ky subject, nuk është i përfshirë në Vendimin Nr. 435, datë 12.09.2002 “PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË SHKARKIMEVE NË AJËR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” .

b. Shkarkime të ujrave të ndotur.

Rritja e lopëve në regjim stallor, shoqërohet me shkarkime të ujrave të ndotur, në përbërje të të cilave është urina e lopëve si dhe ujrata e ndotur me pluhura, mbetje ushqimore të lopëve dhe jashtë qitje të tyre, gjatë pastrimit të ambjentëve të stallës. Këto ujra të ndotur, mbledhen në një kolektor, duke rrëshqitur përgjatë dyshemesë së stallës, për shkak të një pjerrësie të saj. Ky kolektor i dërgon ujrata e ndotur në dy vaska dekantimi.

Gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij, nuk gjenerohen ujra të ndotur teknologjike. Ujrata e shkarkuar, ndoten gjatë pastrimit të pajisjeve të instaluar si dhe të pastrimit të ambjentëve të punës.

Ujrata e zeza shkarkojnë në një gropë septike.

Sipas VKM 177, datë 31.3.2005 “PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE” janë të përcaktuara kritere të tilla si

11.4 Prodhimi i produkteve të qumështit.	pH	6-9
	Lëndët në pezulli	50 mg/l
	BOD ₅	50 mg/l
	COD	250 mg/l
	Yndyrat	10 mg/l
	Nitrati total	10 mg/l
	Fosfori total	2 mg/l
	Rritja e temperaturës në ujrata pritës	1 3°C

c. Gjenerimi i zhurmave.

Gjatë punës për përkujdesjen/rritjen e lopëve për qumësht, nuk gjenerohen zhurma, të tjera nga ato të pëllitjes së lopëve.

Gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike të përpunimit të qumështit dhe, të prodhimit të nënprodukteve të tij kemi gjenerim të zhurmave në ambjentet e punës, gjatë punës së pompave, transportjerëve, pajisjeve të mbushjes së shisheve etj. Janë zhurma me intensitet relativisht të ulët, të cilat nuk pengojnë zhvillimin e bisedave të punonjësve. Këto zhurma nuk ndjehen në ambjentet e jashme të godinës.

Krahas tyre, kemi edhe zhurmat e gjeneruara nga lëvizja e mjeteve të transportit.

Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 75 dBA.

d. Mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Zhvillimi i kësaj veprimtarije shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat përbëhen kryesisht nga jashtëqitjet e kafshëve dhe, mbetjet ushqimore të tyre.

Këto mbetje të ngurta që mund të quhen edhe teknologjike, pastrohen në mënyrë periodike nga stalla e lopëve dhe shkojnë në një gropë dekantimi dhe përpunimi të tyre.

Mbetjet e ngurta urbane, përbëhen kryesisht nga mbetje të ambalazheve prej letre, kartoni, plastike, qelqi etj. Këto mbetje, shkojnë në kazanët e mbetjeve urbane që gjenden brenda teritorit të këtij subjekti dhe, çdo ditë largohen prej aty, drejtë landfillit/inceneratorit të Elbasanit, nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia Elbasan.

Vendimi i KM, nr. 402, datë 30.06.2021 "Për Miratimin e Kataloqut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve".

Ky vendim miraton katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve në përputhje me Katalogun Evropian të Mbetjeve. Në katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve stacionet/pikat e tregtimit me pakicë të naftës përfshihen në :

- 02 MBETJE QË DALIN NGA BUJQËSIA (AGRIKULTURA), KOPSHTARIA (HORTIKULTURA), UJËRAT, PYLLTARIA (SILVIKULTURA), GJUETIA DHE PESHKIMI, SI EDHE PËRGATITJA DHE PËRPUNIMET E USHQIMEVE.
 - 02 01 Mbetjet që vijnë nga bujqësia, nga kopshtaria, nga gjuetia dhe peshkimi
 - 02 01 01 Llumra që vijnë nga larja dhe pastrimi
 - 02 01 03 Mbetje të indeve bimore
 - 02 01 06 Fekale, urinë dhe pleh (duke futur këtu dhe pleh kashtë të prishur), rrjedhje, mbeturina të ndara dhe të trajtuara jashtë qendrës së trajtimit.
 - 02 03 04 Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim.
 - 02 05 Mbetje që vijnë nga industria e prodhimit të qumështit.
 - 02 05 01 Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim.
 - 02 05 02 Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve.
 - 02 05 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara.
 - 20 Metjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas
 - 20 01 01 Letër dhe karton
 - 20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat
 - 20 01 11 Tekstilet
 - 20 1 39 Plastikët

e. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Kemi të bëjmë me një zonë rurale, me zhvillimeve të veprimtarive të fermave bujqësore familjare. Në këtë objekt kanë përfunduar ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj.

Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

f. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme" për t'u shpallur "Peizazh i mbrojtur".

g. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e më sipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të kujdesit/rritjes së lopëve si dhe ai i prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujerave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zones.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerieke egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuara. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapsinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkoshëm.

Në rastin tonë, kemi të bëjmë me ndikime të përkohëshme negative të shkarkimeve në mjedisin psh shkarkimi i mbetjeve të ngurta si fekale, mbetje ushqimore të lopëve etj.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të të kujdesit/rritjes së lopëve si dhe ai i prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.


Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të sejcilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedis dhe, nuk mund të çojnë më tej në përkeqsim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

Në mënyrë të përmbledhur në vijim po paraqesim rekomandime teknike, të cilët duhet të vlersohen dhe zbatohen, me qëllim eliminimin ose zvogëlimin e problematikave aktuale, që kanë tendencë të çënojnë treguesit mjedisor, të ambjenteve të punës.

- a. Kontroll teknik periodik dhe shërbime periodike të mirëmbajtjes të të gjitha pajisjeve/makinerive të instaluar në të dy linjat teknologjike.
- b. Mbajtja e kushteve maksimale të higjenës, në stallën e lopëve dhe në linjën teknologjike të prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij.
- c. Pastrimin dhe dizinfektimin periodik të të gjithë ambjenteve të punës.
- d. Mbetjet e ngurta me natyrë organike, duhet të largohen periodikisht nga ambjentet e stallës dhe të përpunohen/depozitohen në gropën e plehut për tu përshtatur në përdorimin e tyre si pleh organik në tokat bujqësore.
- e. Të mirëmbahen dhe/ose të rikonstruktohen vaskat e dekantimit të ujrave të ndotur, me qëllim rritjen e efiçensës së pastrimit të ujrave të ndotur që shkojnë në to si dhe rritjes së mundësisë së përdorimit të ujrave që dalin nga këto vaska (vadtje, pastrim ambjentesh etj.).
- f. Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të stallave dhe të punonjësve të linjës teknologjike të përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij.
- g. Hartimin e planit të emergjencave mjedisore si dhe të emergjencave që shkaktohen nga faktorë të tillë si rënia e zjarrit, fatkeqsi natyrore etj.
- h. Sistemime dhe mbjellje të fidanëve të rinj të pemëve në kufinjt e pronës.
- i. Sistemimin e të gjitha sipërfaqeve të pazëna me ndërtime, duke synuar rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta.

ECERMA SHPK
Laborator i Akredituar
Gjithmone pranë jush!

SKICA E VASKAVE TE DEPOZITIMIT TE LLUMRAVE



PRERJA A - A



PRERJA B - B



IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë rurale, në të cilën integrohet mjaft mirë në të dy veprimtaritë që zhvillon, stallëne lopëve dhe përpunimin e qumështit.
- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjrike të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vemendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta organike, që dalin nga stalla e lopëve.

Mbetjet teknologjike të ngurta organike, përbëhen kryesisht nga mbetjet e ushqimit për kafshët dhe fekalet e tyre. Këto mbetje largohen çdo ditë nga ambjentet e stallës dhe dërgohen në gropën e depozitimit/përpunimit të tyre e cila gjendet brenda teritorit të administruar nga ky subjekt. Punonjësi i caktuar me këtë punë bën përzjerjen e këtyre mbetjeve organike me dhë të marrë nga toka. Në mënyrë periodike, këto mbetje organike shkojnë për plehrimin organik të fermave bujqësore të zonës.

- b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, drurit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Mbetjet e ngurta urbane, përbëhen kryesisht nga mbetje të ambalazheve prej letre, kartoni, plastike, qelqi etj. Këto mbetje, shkojnë në kazanët e mbetjeve urbane që gjenden brenda teritorit të këtij subjekti dhe, çdo ditë largohen prej aty, drejtë landfillit/inceneratorit të Tiranës, nga subjekte të kontraktuar nga Bashkija Tiranë.

XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europjan, kryesisht në Itali. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të

punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njera prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjije të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjentëve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse të përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidentëve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjerie (ndërtesë, rrjete inxhinjerie etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojmë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe, për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarije.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në këtë subjekt. Këto ndërprerje janë të zakonëshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Aktiviteti I zhvilluar nga ky subjekt, nuk është i përfshirë në përcaktimet/detyrimet e V.K.M.-së Nr. 435, datë 12.09.2002 “PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË SHKARKIMEVE NË AJËR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

Sipas V.K.M.-së Nr. 177, datë 31.03.2005 “PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE” janë të përcaktuara kritere të tilla si

11.4 Prodhimi i produkteve të qumështit.	pH	6-9
	Lëndët në pezulli	50 mg/l
	BOD5	50 mg/l
	COD	250 mg/l
	Yndyrat	10 mg/l
	Nitrati total	10 mg/l
	Fosfori total	2 mg/l
	Rritja e temperaturës në ujrat pritës	1 3 OC

Në kushtet që vendosen zakonisht në lëjen e mjedisit, krahas këtyre treguesve mund të vendosen edhe tregues të tjerë si psh për nivelin e zhurmave, aromat sulmuese etj.

Subjekti duhet të kryej monitorimet periodike duke zbatuar detyrimet ligjore dhe ato të vendosura në lejen e mjedisit,. Këto monitorime, për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar në përputhje me kërkesat e lëgjislacionit respektiv.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Akresi në vendodhjet e matjeve
Ujra të ndotur.	Çdo 6 muaj	Nëkolektorin e shkarkimit n nga vaska e dekantimit.
Niveli i zhurmave.	Çdo 6 muaj	Në ambjentet e punës të linjës së përpunimi të qumështit Jashtëkëtyre ambjenteve.

- FUND-

Ermed Beqaj
Loerma
12/31



Loerma SHPK
NIPT- I 07928204T

LOERMA SHPK

Laborator i Akredituar
Gjithmone pranë jush!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
K.1313/3

MBIEMRI	ZORBA
EMRI	ARMAND
ATËSIA	TANE
DATËLINDJA	16.04.1983, Durrës
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	2007
TITULLI	Ing. Ndërtimi, Profili Infrastrukturë Transporti
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	27.01.2021



NË PROJEKTIM

Kat. 3	a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
	b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
	e	Projektim objekte civile e turistike prej druri.
Kat. 6	a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
	b	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
Kat. 7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
	b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
	d	Projektim ura metalike.
	e	Projektim tunele rrugore - hekurudhore.
Kat. 11	a	Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
	b	Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA



AZHORNOI:
Ing. Armand ZORBA
Lic. K.1313
Date: 04 / 06 / 2022



IDENTIFIKIMI I PASURISE:

Vishaj, Tirane
Rruga B-1, Prane tregut te gjese se
gjalle, Vishaj
TIRANE

Pas. Nr. 212/2 Vol.5, Faq.7, Zk. 3784
me Sip. = 1195m2, Truall

Aktiviteti qe do te ushtrohet:
" Stalle "



PRONAR: Z. Gezim Ali Doci



SH. 1:500

**PLAN-VENDOSJA E STALLES
E NDODHUR NE
Fshatin Vishaj, Tirane**

PLANIMETRIA E STALLES



Stalle
Vendodhja: Vishaj, Tirane
Pronare: Z. Gezim Ali Doci
Sip. Ambjentit: 1195m²
(njemije e njeqinde e nentedhjete e pese)



SH. 1:100



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
K.1313/3

MBIEMRI	ZORBA
EMRI	ARMAND
ATËSIA	TANE
DATËLINDJA	16.04.1983, Durrës
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	2007
TITULLI	Ing. Ndërtimi, Profili Infrastrukturë Transporti
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	27.01.2021



NË PROJEKTIM

Kat. 3	a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
	b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
	e	Projektim objekte civile e turistike prej druri.
Kat. 6	a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
	b	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
Kat. 7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
	b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
	d	Projektim ura metalike.
	e	Projektim tunele rrugore - hekurudhore.
Kat. 11	a	Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
	b	Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA



AZHORNOI:
Ing. Armand ZORBA
Lic. K.1313
Date: 04 / 06 / 2022



IDENTIFIKIMI I PASURISE:



Vishaj, Tirane
Rruga B-1, Prane tregut te gjese se
gjalle, Vishaj
TIRANE
Pas. Nr. 212/2 Vol.5, Faq.7, Zk. 3784
me Sip. = 1195m2, Truall
Aktiviteti qe do te ushtrohet:
" Stalle "
PRONAR: Z. Gezim Ali Doci



SH. 1:500

**PLAN-VENDOSJA E STALLES
E NDODHUR NE
Fshatin Vishaj, Tirane**

PLANIMETRIA E STALLES



Stalle
Vendodhja: Vishaj, Tirane
Pronare: Z. Gezim Ali Doci
Sip. Ambjentit: 1195m²
(njemije e njeqinde e nentedhjete e pese)



SH. 1:100

AZHORNOI:
Ing. Armand ZORBA
Lic. K.1313
Date: 23 / 03 / 2023

Ing. Armand Zorba



Vula / Firma

IDENTIFIKIMI I PASURISE:

Vishaj, Tirane
Rruga B-1, Prane tregut te gjese se
gjalle, Vishaj
TIRANE
Pas. Nr. 212/2 Vol.5, Faq.7, Zk. 3784
me Sip. = 1195m2, Truall
Aktiviteti qe do te ushtrohet:
" Stalle "
PRONAR: Z. Gezim Ali Doci





SH. 1:500

PLAN-VENDOSJA E STALLES

E NDODHUR NE

Fshatin Vishaj, Tirane

PLANIMETRIA E AMBIENTEVE TE PUNES DHE GROPESE
SEPTIKE LIDHUR ME STALLEN





Stalle

Vendodhja: Vishaj, Tirane

Pronare: Z. Gezim Ali Doci

Sip. Ambjentit: 1195m²

(njemije e njeqinde e nentedhjete e pese)



SH. 1:100

PROJEKTIM I
ZORBA
4025 H
K.1313
TIRANE

PROJEKTIM I
ZORBA
4025 H
K.1313
TIRANE

№ 2205



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
K.1313/3

MBIEMRI	ZORBA
EMRI	ARMAND
ATËSIA	TANE
DATËLINDJA	16.04.1983, Durrës
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	2007
TITULLI	Ing. Ndërtimi, Profili Infrastrukturë Transporti
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	27.01.2021



NË PROJEKTIM

Kat.	3	a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
		b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
		e	Projektim objekte civile e turistike prej druri.
Kat.	6	a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
		b	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
Kat.	7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
		b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
		d	Projektim ura metalike.
		e	Projektim tunele rrugore - hekurudhore.
Kat.	11	a	Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësorë, sheshe e parkime.
		b	Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA

